

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, në përbërje nga Kryetari Të Trupit Gjykues – gjyqtarit Arben H, me anëtarët Shpresa Hasaj – Hyseni dhe Agim Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.D, M.H, I.H dhe A.H, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë tani Prokuroria Themelore PP.nr.803-2/2009 dt.03.03.2010, për shkak të veprave penale, i pandehuri F.D për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 nën par. 4 të KPK-së, dhe veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parishikuar nga neni 328 par.2 të KPK-së, ndërsa të pandehurit M.H, I.H, dhe A.H për shkak të veprës penale Vrasje e mbetur në tentative në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me dt.05.02.2018, gjykata pas seancës për këshillim dhe votim, me dt. 08.02.2018, në vështrim të nenit 365 të KPPRK-së, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1. **F.D**, i biri i F. dhe H. i lindur me ..., në fshatin R. i m. K. L, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar.
2. **M.H**, i biri i H, i lindur me ... në fshatin R i M. K. L, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme.
3. **I.H**, i biri i M., i lindur me ... në fshatin R. i M, K. L., ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme.
4. **A.H**, i biri i Sh. dhe N., i lindur me datë ..., në fshatin R.i M. K. L, ku edhe jeton, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

### JANË FAJTOR

**Sepse** më datën 05.09.2009 rreth orës 19:15 minuta, në fshatin Ribar i Madh, Komuna e Lipjanit, derisa I pandehuri F.D së bashku me axhën e tij R., vëllain M. dhe motrën e tij E.D kanë qenë duke udhëtuar me autobusin e firmës “T”, të cilin e drejtonte shoferi F.J, në momentin kur autobusi ka arritur në kthesën e fshatit Ribar i Madh, për shkak të një konflikti të mëparshëm që e kishin ndërmjet vetit familja H. dhe D. për çka edhe ishin rrahur tre muaj më parë, tani të pandehurit H. kanë dalur nga kombi i tyre i tipit “Toyota” me targa ... me ngjyrë të kuqe , i cili ka qenë i ndalur në mes të rrugës, e kanë ndalur autobusin, ku të pandehurit F. dhe Xh.H kanë qenë të armatosur me armë zjarri të tipit të pa njohur, të cilat i mbanin pa autorizim, ndërsa të pandehurit B. dhe M.H me shkopinj druri, i pandehuri I. me teslicë ndërsa I pandehuri A. me shufër hekuri, në atë mënyrë që i pari në autobus ka hyrë i

pandehuri F.H me pistoletë në dorë dhe pasi që ju ka thënë D. “zbritni poshtë” dhe në atë moment ka shtënë me pistoletën e tij ka qëlluar në këmbë të dëmtuarin R.D. duke i shkaktuar dëmtime të rënda trupore, po ashtu ne autobus ka hyrë edhe të pandehurit I., M. A, dhe B, me pajisë si më lartë, me të cilat kanë goditur të dëmtuarin R, M dhe E, të cilëve ju ka shkaktuar dëmtime të rënda trupore, ndërsa në ato momente I pandehuri F.D duke qenë paraprakisht I përgatitur, për të zmbarsur sulmin të atëçastshëm dhe real prej vetës dhe të tjerëve, ka nxjerrë nga brezi pistoletën e tipit Crevena Zastava M-57 e kal .7.62 x 25mm me nr serik G-82691 të cilën e mbante pa autorizim dhe ka shtënë fillimisht në drejtim të këmbëve të të pandehurit F.H, dhe pasi i pandehuri F.ka pushuar se sulmuari – gjuajtur me armë, i pandehuri F.D duke vepruar në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme ka shtënë një herë edhe në drejtim të Q.H I cili ka qenë në autobus, nga i cili plumb Q.H ka ndërruar jetë në Qendrën Emergjente në Prishtinë, me ç’rast i pandehuri F.D ka rrezikuar kështu edhe jetën e njerëzve tjerë në autobus, ku nga një e shtëne e pa kontrolluar e të pandehurit F, është qëlluar edhe udhëtari i rastit në autobus E.H, i cili ka pësuar dëmtime të rënda trupore të rrezikshme për jetën e tij, ndërsa nga të shtënat e të pandehurit F. lëndime trupore kanë marrë edhe të pandehurit H, ndërsa i pandehuri Xh.H, natën kritike është futurë në autobus nga dera e pasme me pistoletë e tipit të panjohur në dorë, dhe të njëjtën i ka drejtuar në gjoks të dëmtuarit M.D i cili ka arritur që të ia ulë pistoletën me tytë teposhtë dhe me atë rast i pandehuri e ka qëlluar atë në pjesën e këmbëve duke i shkaktuar dëmtime të rënda trupore.

- Me këtë i pandehuri F.D ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 nën par. 4 në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 nënpar. 3 të KPK-së, dhe veprën penale Mbjtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, parashikuar nga neni 328 par.2 të KPK-së.
- Të pandehurit M.H, I.H dhe A.H në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vrasje e mbetur në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së.

Andaj, Gjykata bazuar në nenet e lartpërmendur dhe nenet 3,6,8,20,23,34,35,38,64, të KPK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, të pandehurve I përcakton:

## **DËNIM ME BURGIM**

### **1. Të pandehurit F.D**

- Për veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 nën par. 4 në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 8 par 3 të KPK-së, I përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite, e 6 (gjashtë) muaj.
- Për veprën penale Mbjtje në pronësi të paautorizuar të armëve, parashikuar nga neni 328 par.2 të KPK-së, i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Bazuar në nenin 71 të KPK-së, të pandehurit, Gjykata i shqipton:

## **DËNIM UNIK ME BURGIM**

Të pandehurit **F.D**, i shqipton dënim unik **me burg në kohëzgjatje 7 (shtatë) vite**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe atë prej dt. **05.09.2009, deri me dt.14.10.2014**, e cila masë i është caktuar edhe pas shpalljes së aktgjykimit, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më gjatë se koha e dënimit të shqiptuar me aktgjykim të kësaj gjykate.

## **2. Të pandehurit M.H gjykata I shqipton:**

Dënim me burim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, e 5 (pesë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak

## **3. Të pandehurit I.H, gjykata I shqipton:**

Dënim me burim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, e 5 (pesë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak

## **4. Të pandehurit A.H, gjykata I shqipton:**

Dënim me burim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite, e 5 (pesë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak

Të akuzuarit secili veç e veç obligohen t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili veç veç shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) euro në afat prej 30 ditëve, pasi ky aktgjykim të merr formë të prerë.

Të dëmtuarit N.R, E.H, M.D, R.D, dhe E.D për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko – civil.

Konform nenit 69 të KPRK-së dhe konform nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet:

Arma e tipit - Crevena Zastava M-57 e kal.7.62 x 25mm me nr.serik G-82691, dhe TT, karikator i armës automatike AK47 me 17 fishek.

## **A r s y e t i m**

### **1. Historiku i procedurës**

1.1. Me datë 03.03.2009 Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë (tani Prokuroria Themelore në Prishtinë) ka ngritur aktakuzë PP.nr.803-2/2009 për shkak të veprave penale F.D për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 lidhur me par 4 të KPK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, ndërsa F.H, B.H, M.H, Xh.H, I.H dhe A.H për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Vrasje në tentativë parashikuar nga nenin 146 par. 20 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa të akuzuarit F. dhe Xh.H edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Aktakuza PP.nr.803-2/2009 e datës 03.03.2009 është dorëzuar në gjykatë me të njëjtën date. Kjo aktakuzë është konfirmuar nga gjykatësi për konfirmim të aktakuzës me vendimin KA.nr. 52/10 të datës 08.04.2010.

1.2. Kjo Gjykatë me dt.14.10.2014, ka marr aktgjykim PKR 16/13, ku ka shpallur fajtor të pandehurit dhe I ka dënua si në aktgjykimin e lart cekur. Me aktvendimin PAKR.nr 224/15 dt.13.07.2015 Gjykata e Apelit të Kosovës, gjykatës së shkallës së parë I ka kthyer në ri gjykim dhe rivendosje çështjen.

1.3. Gjykata për shkaqe të arsyeshme ka veçuar lëndën për të pandehurit F.H dhe B.H, me aktvendimin e datës 01.12.2017, si dhe për të pandehurin Xh.H me aktvendimin e datës 06.02.2017, meqenëse të pandehurit nuk janë paraqitur në seancë gjyqësore, dhe pas verifikim të vendndodhjes së tyre nga ana e policisë është mësuar se të njëjtit janë larguar nga Kosova ne drejtim të vendeve perëndimore, ndërsa Gjykata kundër të njëjtëve ka lëshuar letër rreshtim si dhe ka nxjerrë aktvendim për caktim paraburgimit me qëllim që të sigurohet prezenca e të këtyre të pandehurve në procedurë.

1.4. Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore të datës 06.02.2018, 14.03.2017, 19.12.2017, 05.02.2018, në të cilën kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë.

Pasi që shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale kishte filluar dhe ndërprerë disa here nga trupe të ndryshme gjyqësore, trupi i ri gjyqësor konform nenit 311 të KPPRK-së ka filluar rishtazi shqyrtimin gjyqësor. Mirëpo, me propozimin e palëve është bërë leximi i deklaratave të dhëna në shqyrtimet e mëparshme gjyqësore.

## **2. Shqyrtimi gjyqësor dhe deklaratimet e palëve**

2.1. Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve. Prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë qëndruar në tërësi pranë fjalëve hyrëse dhe dhëna në shqyrtimet e kaluara gjyqësore, ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi ka vazhduar me dëshminë e dëshmitarëve, të cilët kanë ngelur pranë deklaratave të dhëna në shqyrtimet e mëparshme.

2.2. E dëmtuara – dëshmitarja N.R gjatë dëshmisë së saj të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk kishte qenë në dijeni se familja D. kishte pasur mosmarrëveshje me birin e saj tani të ndjerin Q.H, poshto e njëjta deklaroi se biri i saj tani më i ndjeri Q. kishte punuar në Prishtinë së bashku me djalin tjetër të saj H.H. Po ashtu e njëjta shtoi se jetonte në fshatin R.M, komuna e L. të akuzuarit F., B.,M, Xh. dhe A.H i ka djemtë të kumatit, gjithashtu deklaroi se me familjen D. tani më ishin pajtuar dhe se paraqet kërkesë pasurore juridike ndërsa sa i përket dënimit për të akuzuarin ja lë Gjykatës që të vendos lidhur me këtë çështje.

2.3. Në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datën 18.01.2011 dëshmitari – i dëmtuari M.D deklaroi se pasi që i njëjti kishte hipur në autobus kishte parë vëllaun e tij tani të akuzuarin F.D, axhën e tij R. si dhe motrën E.D, ndërsa nuk kishte vërejtur që në autobus kishte qenë ndonjë nga anëtarët e familjes H, ndërsa në fshatin P. kishte vërejtur kombin e familjes H. i cili në hyrje të fshatit R.M kishte dalur në mes të rrugës duke ja

pamundësuar autobusit që të kalonte në vijë të lirë dhe më pas kishte parë që nga kombi kishin dalur anëtarët e familjes H. Nga dera e parë e autobusit kishte hyrë F.H i cili kishte revole në dorë dhe të njëjtit i ishte drejtuar se “ku po donë me shku tash”, ndërsa I.H, A.H (i cili kishte pajser në dorë), M.H (i cili kishte sopatë në dorë) dhe V.H së bashku me Xh.H i kishte parë tek hynin nga dera e pasme e autobusit. Xh.H tytën e revolës ja kishte vendosur në barkë dhe pasi që kishte tentuar që t’ia hiqte të njëjtin e kishte goditur me teshlicë në dorë të djathtë dhe në pjesën e shpinës I.H, dhe duke u munduar që të largonte tytën e revolës të vendosur në pjesën e barkut nga Xh.H të njëjtën tytë e kishte shtyrë deri në pjesën e poshtme ku më pas ishte goditur dy herë në këmbën e djathtë mbi gju dhe në afërsi të gjurit, më pas i akuzuari Xh.H (edhe pse kishte pasur udhëtar tjerë në autobus) kishte shtënë edhe dy herë në drejtim të të njëjtit por nuk kishte mundur që ta godiste, më pas kishte parë edhe M.H i cili ishte nisur nga dera e parë e autobusit me një sopatë në dorë, pastaj nga dera e mbrapme kishte hyrë V.H me një stupcë në dorë e i cili kishte filluar që ta godiste në duar ku edhe ishte gjakosur dhe kishte dëgjuar të akuzuarin I.H i cili në dorën majtë mbante një teshlicë ndërsa në të djathtë mbante revole duke thënë se “nxirreni ja q.. nanën dhe i vrahme”, po ashtu i njëjti deklaroi se në ditën kritike kishte parë të ndjerin Q.H në pjesën e pasme të autobusit ndërsa të njëjtit nuk i kishte parë asgjë të ketë pasur në dorë, ndërsa nuk e kishte parë vëllaun e tani të ndjerit Q.H, H.H të ketë qenë në autobus, po ashtu i njëjti deklaroi se axhën e tij R.D e kishte plagosur F.H, ndërsa për motrën e tij E.D shton se e njëjta ishte goditur por jo me armë, por se nga kush ishte goditur nuk e kishte parë dhe nga goditjet e marra i njëjti deklaroi se posa kishte zbritur nga autobusi në tokë i kishte humbur vetëdija dhe më nuk kishte ndjerë asgjë dhe se nuk e kishte pasur idenë se kush e kishte privuar nga jeta tani të ndjerin Q.H, por shton se në autobus nuk kishte pasur të shtëna të vetëm nga një revole por kishte dëgjuar krisma që vinin nga më shumë se një revole dhe po ashtu i kishte parë në dorë një revole edhe B.H por për të njëjtin nuk e dinte në kishte shtënë në drejtim të tij apo jo i njëjti gjithashtu deklaroi se kjo kacafytje kishte filluar diku para një viti ku njëri nga anëtarët e familjes H kishte pasur një mosmarrëveshje me vëllaun e tij të akuzuarin F.D.

2.4. Në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datën 24.02.2011, i dëmtuari - dëshmitari R.D deklaroi se deri sa ishte duke u kthyer me djalin e vëllait F.D dhe vajzën e vëllaut E.D nga puna me autobus të njëjtin e kishte parë se ishte ndaluar pasi që në rrugë kishte dalë një kombi dhe në këtë mënyrë ja kishte pamundësuar lëvizjen e lirë, më pas nga po i njëjti kombi kishte parë të dilnin 13-14 persona të cilët edhe i kishte identifikuar si pjesëtarë të familjes H, pasi që të njëjtit i kishte të njohur edhe më parë, po ashtu i njëjti deklaroi se nga dera e parë e autobusit kishte parë të ketë hipur i akuzuari F.H (me revole në dorë) i cili e kishte goditur me dy predha në këmba dhe pas tij I.H (me teshlicë në dorë) duke bërë titur në drejtim të djalit të vëllaut të tij F.D se “a po e sheh që të zura, ku po donë me shku tani”, i njëjti ishte ngritur në këmbë në mënyrë që mos ti lejonte që të njëjtit t’ia godisnin djalin e vëllaut të tij F.D dhe në atë moment i njëjti ishte goditur nga teshlica të cilën e mbante në dorë I.H dhe nga lëndimet e marra kishte rënë në tokë pavetëdije duke mos e ditur se sa herë e kishte goditur i njëjti me teshlicë dhe shton se vetëdija i kishte ardhur tek vendi i quajtur te “Kopinat”, e i cili vend kishte qenë larg nga autobusi rreth 3-4 metra, i njëjti po ashtu deklaroi se nuk i kujtohej që në ditën kritike të ketë parë a ishte apo jo në autobus tani më i ndjeri Q.H.

2.5. Në dëshminë e saj të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datën 24.02.2011 dëshmitarja E.D deklaroi se deri sa ishte duke u kthyer me autobus me vëllaun e saj F.D, axhën e saj R.D nga puna, kishte vërejtur që autobusi ishte ndalur në hyrje të fshatit R.M, pasi që i njëjti ishte penguar nga një kombi nga i cili kishte parë të dilnin persona ku edhe kishte identifikuar F.H dhe I.H, të cilët kishin hyrë në autobus nga dera e parë dhe kishte parë F.H duke shtënë me revole xhaxhanë e saj R.D i cili tentonte që ti dilet përpara vëllaut të saj F.D. Pasi që kishte parë që xhaxhai i saj nga goditja që kishte marr kishte rënë pa shenja jetë në dysheme të autobusit e njëjta kishte tentuar që ti dilet vëlluat të akuzuarit F.D përpara, mirëpo sipas deklaratës së të njëjtës në atë moment kishte humbur vetëdijen, për të cilën nuk i kujtohej se si i kishte ndodhur dhe kur e njëjta i ishte kthyer kishte parë vetën në një llogorë së bashku me axhën e saj R.D i cili kishte qenë i mbuluar me gjak dhe pasi që kishte dëgjuar I.H të ju ketë thënë familjarëve kthehuni se “gjallë qenka”, (aludon për axhën e saj R.D), e njëjta kishte rënë sipër tij dhe nuk i kishte lënë që të njëjtit ta godisnin atë me shkop druri. Gjithashtu e njëjta deklaroi se më nuk i kujtohej të ketë parë vëllezërit e saj M dhe F.D dhe shtoj po ashtu se deri sa të njëjtit kishin qenë në autobus vëllai i të njëjtës i akuzuari F.D kishte telefonuar Policinë.

2.6. Dëshmitarit F.D deklaroi se në ditën kritike deri sa kishte qenë në arën e tij, kishte parë tek kalonte një kombi me ngjyrë të kuqe dhe pasi që kishte qenë në dijeni se familja H. kishte një kombi të kuq, menjëherë kishte njoftuar djalin e tij të akuzuarin F.D duke i thënë “thirre policinë se situata nuk është e mirë” dhe më pas edhe vet ai kishte telefonuar policinë dhe pasi që i njëjti kishte shkuar në shtëpi njëri nga kushërinjtë e tij Q.D i kishte thënë “fëmijët ti kanë mbytur H.” dhe deri sa i njëjti kishte mbërritur në vendin e ngjarjes Polica kishte arritur të shkonte para tij. Po ashtu i njëjti deklaroi se në vendin e ngjarjes kishte parë dy fëmijët e tij F.D dhe E.D të hedhur në llogore në skaj të rrugës dhe që të dytët sipas tij kishin qenë në gjendje shumë të rëndë pasi që të dy ishin të lënduar, ndërsa R.D vëllain e tij i njëjti nuk e kishte parë. Gjithashtu i njëjti deklaroi se atë ditë djalit të tij tani të akuzuarit F.D nuk i kishte parë armë në dorë, por se i njëjti kishte pasur armë në ditën kritike e kishte kuptuar pasi që i njëjti kishte ndalur nga paraburgimi, ku i njëjti, edhe ja kishte pranuar se në ditën kritike kishte shtënë me armë në drejtim të F.H pasi që kishte menduar se i njëjti edhe i kishte vvarë axhën e tij R.D.

2.7. Dëshmitari P.V deklaroi se në ditën kritike deri sa kishte qenë duke u kthyer nga puna me autobus me të cilin udhëtonte zakonisht dhe deri sa ishte duke fjetur në autobus kishte dëgjuar një tollovi dhe i njëjti kishte zbritur nga autobusi duke hipur në një autobus tjetër dhe tjetër gjë nuk i kujtohej.

2.8. Dëshmitari I.H deklaroi se në ditën deri sa kishte qenë në autobus së bashku me vëllezërit e tij N.H, E.H dhe H.H, në fshatin Putorovc, kishte hypur edhe tani më i ndjeri Q.H i cili kishte hyrë nga dera e pasme, në autobus kishin qenë të ulur edhe F,M, R dhe E.D, i njëjti deklaroi se deri sa autobusi ishte në lëvizje në rrugë për ta ndalur atë kishin dalë F dhe I.H dhe pas tyre kishin qenë A, M,Xh,B. Gjithashtu i njëjti deklaroi se të shtënat e armëve i kishte ndëgjuar deri sa i njëjti ishte munduar të zbriste nga autobusi dhe më pas ishte kthyer

në autobus pasi që të njëjtin e kishte thirrur vëllau i tij N. dhe i njëjti e kishte njoftuar se në autobus kishte mbetur i plagosur vëllau i tyre E. H.

2.9. Dëshmitari V.H deklaroi se rreth një muaj para ngjarjes kritike të njëjtin e kishin rrahur F,M, Sh dhe F.D në vendin e quajtur “Strama” në fshatin Ribar i Madh, kjo rrahje kishte ndodhur si pasojë ngase të njëjtit kishin pasur edhe një ngatërresa më herët dhe sipas tij i njëjti nuk kishte qenë në vendin e ngjarjes në ditën kritike dhe nuk ishte në dijeni për atë se çfarë kishte ndodhur, pasi që nga puna kishte qenë i lodhur dhe nuk ishte ndalur fare në Lipjan me të tjerët, po vetëm kishte vazhduar rrugën për në shtëpinë e tij në fshatin R.M, po ashtu i njëjti deklaroi se tani më të ndjerin Q.H e kishte pasur djalë të axhës dhe se sipas informative që ai kishte marr në ditën kritike deri sa kishte qenë në autobus të njëjtin e kishte kërcënuar F.D dhe pas kësaj i njëjti i kishte shkruar një sms F.H duke i treguar për kërcënimin e tij nga ana e të akuzuarit F.D.

2.10. Dëshmitari I.H ka dëshmuar se në ditën kritike kishte qenë në punë në kompaninë “F” në Prishtinë dhe pas përfundimit të orarit të punës me kombi ishte nisur së bashku me A.H( i cili edhe e kishte vozitur), e po ashtu kishte qenë edhe V, I, F, M dhe M.H dhe më pas nga Prishtinë ishte ndalur në Lipjan, ku kishte vazhduar rrugën së bashku me V dhe I.H për në fshatin tij, po ashtu deklaroi se në ditën kritike nuk kishte pasur asnjë kontakt me të ndjerin Q.H por deklaroi se kishte kuptuar se ai i kishte dërguar sms F.Ht duke i treguar për kërcënimin që po i bënte të njëjtit F.D, gjithashtu i njëjti deklaroi se kësaj ngjarje i kishin paraprirë dy kacafytje të mëhershme që kishin pasur në mes vete familja e tyre me familjen D.

2.11. Dëshmitari S.D deklaroi se në kompaninë “F” kishte qenë në cilësinë e personit përgjegjës dhe se kombi i kompanisë nga pronari i kompanisë kishte qenë në shërbim të punëtorëve, po ashtu deklaroi se në kompaninë “F” nuk kishte punuar tani më i ndjeri Q.H.

2.12. Dëshmitari H.H deklaroi se të ndjerin Q.H e kishte pasur vëlla dhe se për ngjarjen kritike kishte kuptuar deri sa kishte qenë në shtëpi. Sipas deklaratës së të njëjtit deri te kjo ngjarjes ka ardhur si pasojë e dy konflikteve të mëhershme në mes tyre dhe familjes D. Gjithashtu i njëjti deklaroi se kishte dëgjuar që në ditën kritike të akuzuarit F.H tani më i ndjeri vëllau i tij Q.H i kishte dërguar sms duke i treguar për kërcënimet që F.D i bënte të njëjtit.

2.13. Dëshmitari H.H deklaroi se ditën kritike deri sa kishin qenë duke e pritur autobusin në fshatin Putoroc, kishte parë tek kalonte një figuron me ngjyrë të kuqe në drejtim të Lipjanit e i cili më pas ishte kthyer pas autobusit në të cilin kishin hipur edhe vetë ata, i njëjti po ashtu deklaroi se në autobus kishte qenë së bashku me vëllezërit e tij N.H, I.H dhe E.H ,po ashtu deklaroi se deri sa ishte në këmbë dy apo tri karrika larg shoferit dhe në afërsi të fshatin Ribar i Madh, kishte parë 4-5 persona të cilët i kishin bllokuar rrugën autobusit, po ashtu kishte vërejtur edhe kombin me ngjyrë të kuqe të cilin e kishte parë më herët në lëvizje, personat që kishin ndalur në rrugë sipas tij kishin qenë M.H, I.H, V.H e po ashtu edhe katër-pesë persona të tjerë të cilët nuk kishte qenë në gjendje me i identifikuar dhe posa ishte hapur dera e autobusit kishte parë që nga dera e parë të kishte hipur F.H dhe sipas tij menjëherë kishte filluar rrahja dhe i njëjti shtoj se menjëherë kishte shkruar dhe ishte

fshehur nën karrige deri sa kishte përfunduar e tërë ngjarja , gjithashtu deklaroi se deri sa kishte qenë i shtrirë ndër karrige kishte parë që në dyshtemenë e autobusit ishte shtrirë F.H i cili edhe ishte plagosur, po ashtu deklaroi se në autobus kishte pasur të shtëna armësh të cilat kishin qenë me ndërprerje. Gjithashtu i njëjti deklaroi se vëllai i tij E ishte i plagosur nga shpina por predha e tij kishte mbetur në qafë dhe nga ajo predhë i njëjti kishte mbetur i paralizuar në pjesën e poshtme të trupit, po ashtu i njëjti deklaroi se me familjen H nuk ishin në lidhje gjaku ,por që më të njëjtit sikurse me familjen D. deri para ngjarjes kritike kishin pasur raporte të mira, ndërsa pas kësaj ngjarje me të dyja familjet më nuk kishin folur më.

2.14. Dëshmitari N.H deklaroi se deri sa ishte duke u kthyer me autobus nga puna së bashku me vëllezërit e tij me të cilët punonin në një ndërtim të një shtëpie në fshatin Poturovc, kishte parë që në hyrje të fshatit Ribar i Madh , në kthesën e djathtë ishte ndalur një kombi ku pengonte lëvizjen e lirë të autobusit dhe se afër tij kishin dalë një grup prej disa njerëzish nga tetë deri në njëmbëdhjetë persona dhe se nuk i kujtohej se si ishte ndalur autobusi, por i kujtohej se së pari kishin hipur A. dhe M.H të cilët kishin filluar që ti sulmonin anëtarët e familjes D të cilët ishin në autobus, për të cilët nuk kishte qenë në dijeni nëse kishin pasur apo jo problem me herët në mes vete, gjithashtu i njëjti deklaroi se kur kishte dalë nga autobusi kishte dëgjuar krisma armësh të cilat vinin nga autobusi, ndërsa nuk kishte mundur që ta identifikonte se kush kishte dalë më pas nga autobusi, ngase i njëjti kishte qenë i fokusuar tek vëllau i tij E.H, ku i njëjti kishte qenë i plagosur dhe i mbuluar në gjake.

2.15. Dëshmitari A.J deklaroi se punon në kompaninë “T.T” në cilësinë e konduktorit dhe se F.J e ka vëlla dhe se me të njëjtin jeton në bashkësi familjare i njëjti gjithashtu deklaroi se nuk i kujtohet momenti kur ishte ndalur autobusi, ngase kishte qenë ulur në ndjesën e pasme të autobusit, por i kujtohej kur kishte parë të hapeshin dyert ku nga të cilat ishin futur personat e familjes H, ku në çast kishin filluar përleshjen me pjesëtarët e familjes D. dhe atë me F. dhe R.D. Po ashtu deklaroi se kishte dëgjuar krisma të armës të cilat kishin qenë shtatë-tetë krisma të cilat kishin ardhur nga pjesa e parë e autobusit, por për të cilat nuk ishte në dijeni se kush kishte shtënë, ngase kishte qenë i frikësuar dhe ishte fshehur pas karrige.

2.16. Dëshmitari F.J deklaroi se në ditën kritike deri sa ishte duke e drejtuar autobusin, në kthesë për në fshatin Ribar i Madh, kishte parë disa udhëtar (të cilët i kishte të njohur vetëm si figura) të cilët ja kishin bërë me dorë që të ndalej, ndërsa kombi të ndalur në rrugë i njëjti nuk kishte parë, dhe posa kishte hapur derën e autobusit në të njëjtin kishte hyrë F.H dhe në moment kishte filluar të qajë djali i tij, ku më pas kishte marr djalin dhe kishte dalë nga autobusi. Sipas tij e tërë ngjarja kishte ndodhur shumë shpejt dhe se i njëjti nuk kishte mundur që të identifikonte asgjë, por vetëm kombin e kuq me të cilin kishin shkuar Hotët pasi që kishin dalë nga autobusi.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor:**

3.1. Gjykata gjithashtu lexoi dhe vlerësoi raportin e autopsisë nga Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore për Q.Hn të datës 08.09.2009, Raportin nga shiqimi i vendit të ngjarjes i datës 05.0-9.2009, Raportin e forenzikës të datës 05.09.2009, raportin e zinxhirit të ruajtjes së



dëshmime të datës 05.09.2009, raportin e ekzaminimit kriminalistik nga sektori i armëve të zjarrit dhe gjurmëve të veglave i datës 01.12.2009, raportin për hyrje dalje të SMS –ve nga operatori Vala, procesverbalin mbi vendin e ngjarjes i datës 05.09.2009,raporti mjeksor për të akuzuarit Jusuf Hn, ka bërë shiqimin e foto dokumentacionit në shkresat e lëndës, janë lexuar konstatimet dhe mendimet mjeko ligjore për të dëmtuarin R.D, M .D dhe E.H, të dhëna me datë 22.02.2010, nga eksperti Dr.T.G, dhe është bërë leximi i fletë lëshimit të spitalit për të akuzuarin B.H, Ekspertiza mjeko-ligjore e datës 21.04.2017 për lëndimet e të pandehurit M.H, F.D, A H, Bedri H, F.H, I.H, të dëmtuarit M.D, R.D, dhe E.D.

#### **4. Mbrojtja e të pandehurve**

Në këtë çështje penale meqenëse se lënda është kthyer në rigjykim të pandehurit kanë qëndruar pranë mbrojtjes të cilën e kanë dhënë në shqyrtimin e parë gjyqësor.

4.1. **I akuzuari F.D** në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimit gjyqësor, deklaroi se në ditën kritike ka punuar në autolarje në Lipjan, prej orës 08:00-19:00, zakonisht ka udhëtuar me autobusin “T” i cili ka arritur në orën 19:00-19:10 në stacionin e Lipjanit dhe i njëjtit ka vazhduar për fsh. Ribar i Madh në orën 19:15h. Atë ditë kishte takuar R.D dhe E.D, axhën respektivisht motrën e tij. Ne autobus kishte hipur edhe vëllau im R.D i cili punon në firmën “R.C”. Motra ka qenë në këmbë para axhës tij dhe para tij, ndërsa vëllai M. D ishte i ulur mbrapa tyre, nuk e di saktë se në cilën ulëse. Gjatë rrugës kishte kontaktuar me babanë e tij F.D. Gjatë asaj bisedës babai më kishte sugjeruar që të kem kujdes ngase i kishte parë duke e përgatitur kombin familja H. Në afërsi të familjes H rreth 200 m gjendet ara e tyre, dhe të njëjtit i kishte parë. Posa e kishte njoftuar babai, ai ka lajmëruar policin e Lipjanit. Bisedën mes babait e kishte dëgjuar edhe xhaxhai i tij Ri. Para ngjarjes kritike e kishte përcjellë kombi i cili lëvizte para dhe mbas autobusit ku gjendej i akuzuari me familjarët e tij. Kombin e ka parë nga Lipjani gjegjësisht në fsh. Ribar i Madh. Deri sa ka qenë duke punuar në autolarje, kishte ardhur kombi i njëjtë, kishe ndaluar para tij dhe me vrull kishte dhënë gaz. Një ditë para natës kritike, gjatë përcjelljes me kombi gjendeshin M, M, V dhe H.H. Kjo ngjarje kishte ndodhur një vit më parë dhe për këtë nuk janë pajtuar. Pas një viti kemi pasur një darsëm te arra e tyre dhe derisa ishte me vllaun M, në afërsi ka qenë V. dhe një person tjetër me mbiemrin H. dhe janë rrahur në mes veti. Te lartcekurit i kanë rrahur, ky rast është paraqitur në stacionin Policorë në Lipjan por asgjë nuk është ndërmarr rreth kësaj ngjarje.

4.2. Ditën kritike në hyrje të fshatit Ribar, familja H kishte ndal kombin në mes të rrugës, autobusi ishte ndal 2m nga kombi. Pasi janë ndalur, nga kombi kishte zbritur i pari F.H me revole në dorë, Ii me teslicë ndërsa M H me Sopat në dorë. Të akuzuarit i kanë hapur dyert e autobusit me dhunë, ishin rreth 12-13 persona, te dera e parë e autobusit ishin F, I dhe M, ndërsa të tjerët kanë hyre ka dera e pasme. Posa kishte hipur Fi kishte drejtuar revolen në drejtim të tij dhe kishte thënë “D. zbritni në toke” , pastaj ishte ngritur xhaxhai i tij, ku Fi menjëherë kishte shtënë në drejtim të këmbëve të tij, të njëjtin e kishin qitur në tokë I, F dhe M dhe kishin filluar ta rrahin. Në atë moment kishe dal motra e tij dhe kishte hipur përmbi xhaxhain për ta mbrojtur nga rrahja. Pastaj F kishte hipur përsëri në autobus dhe ishte nisur në drejtimin e tij dhe i kishte thënë “nuk ke ku shkon” dhe kishte shtënë një herë në drejtim të gjoksit të tij, nuk e kishte qëlluar sepse isha prapa karriges. Pastaj i akuzuari kishte nxjerrë

revolen nga brezi dhe ka shtënë dy here në drejtimin të akuzuarit F.H, tij në drejtim të këmbeve në pjesën e poshtme, largësia ishte rreth 2m. Në atë moment e ka goditur me teslicë në kokë I, dhe i ka shkaktuar plagë në kokë, nga kjo goditje e ka humbur vetëdijen, kur i ka ardhur vetëdija ishte ne emergjencë në Prishtinë. Nuk e din se kush e ka vra Q.H dhe se i njëjti nuk e ka parë të ndjerin fare atë dite.

**4.3. I akuzuari M.H** në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se ditën kritike ka qenë në punë në Prishtinë nga ora 08.00 deri në ora 18.00 së bashku me anëtarët e familjes së tij dhe se janë kthyer së bashku me kombi. Nuk i kujtohet se ku kanë qenë saktësisht por i kujtohet se F.H iu kishte thënë se Q. gjendet në autobus dhe se po e kërcënojnë djemët e F. Atëherë e kanë ndalur kombin dhe i pari nga kombi ka dalë F. dhe ka shkuar në autobus dhe në një moment ka dëgjuar krisma të revoles atëherë kanë dalur nga kombi dhe diku 3 deri 4 metra pa mbërritur tek autobusi e ka gjuajtur F.D. As ai as të tjerët nuk kanë pasur asgjë në dorë në momentin kur janë nisur për në autobus. I njëjti deklaroi se F. ka dalë te dera e përparme e autobusit dhe e ka qëlluar të njëjtin. Pasi është plagosur në shpine dhe gishtin e dorë së majtë e ka humbur vetëdijen dhe nuk din asgjë se çfarë ka ndodhur më tutje.

**4.4. I akuzuari I.H** në deklaratën e tij të dhënë shqyrtim gjyqësor deklaroi se ditën kritike ka punuar në Prishtinë prej orës 08.00 e deri në 18.00. Nga puna është kthyer së bashku me familjarët e tij me kombin e firmës. Kur kanë mbërritur te rruga e fshatit Ribar i Madh, Q.H i kishte dërguar sms F. se gjendet në autobus dhe se ndjehet i rrezikuar nga familja D. Ata e kishin ndalur kombin dhe në atë moment ka zbritur F.H që ta marrë Q, pasi ka hyrë F. në autobus ka ndërguar tri deri katër të krisura të revoles. I njëjti kishte qëndruar në kombi përderisa të gjithë të tjerët kishin dalë nga kombi ndërsa disa udhëtarë pasi kishin dalë nga autobusi ishin afruar tek ai dhe i kishin thënë se çka po rrinë këtu kur F. i vrau F. dhe Q. I njëjti kishte dalë nga kombi kishte pasur një teshlicë në dorë dhe me të njëjtën e kishte goditur në dorë të akuzuarit F.D. I njëjti ka hyrë në autobus vetëm kur e ka marrë të ndjerin Q. dhe F.

**4.5. I akuzuari A.H** në deklaratën e tij të dhënë në polici me datë 28.09.2009, kishte deklaruar se ai kishte qenë duke vozitur kombin dhe dikush në kombi kishte thënë ndale ta marrim Q. se qenka në autobus. Nga kombi kanë dalë 2-3 persona dhe janë nisur në drejtim të autobusit dhe aty ka dëgjuar disa krisma të revoles dhe atëherë ka dalë edhe vetë si dhe të tjerët nga kombi dhe janë nisur në drejtim të autobusit aty e ka parë F. duke zbritur nga autobusi dhe F. i ka drejtuar revolen në gjoks dhe pasi ky i ka ulur revolen poshtë i njëjti e ka goditur në këmbë. Pasi ka hyrë në autobus e ka parë Q. dhe F. të shtrirë dhe me ndihmën e të tjerëve i ka futur në kombi dhe iu kanë dërguar në Prishtinë. Nuk e din se të kujt kanë qenë stupcat që janë gjetur në vend të ngjarjes por ai nuk ka pasur asgjë në dorë.

## **5. Fjala përfundimtare e palëve**

5.1. Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ngeli në tersi pranë fjalës përfundimtare të prokuroritë shtetit dhënë në shqyrtimin e kaluar gjyqësor.

5.2. Përfaqësuesi I autorizuar palës së dëmtuar të ndjerit Q.H, avokati O.M sipas autorizimit zëvendësues për av.ZH.J, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar, se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë nga av.ZH.J, duke shtuar se I bashkëngjiten ndjekjes penale dhe parashirojnë kërkesë pasurore – juridike, të cilën nuk e kanë precizuar.

5.3.Të dëmtuarit Nazife H, H.H, N H kanë deklaruar se e përkrahin fjalën përfundimtare të paraqitur nga përfaqësuesi I tyre I autorizuar.

5.4. I dëmtuari R.D në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se qëndron pranë fjalës së dhënë në shqyrtimin e kaluar, dhe nuk ka diçka tjetër të shtojë. E në të cilën fjalë përfundimtare ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se paraqet kërkesë pasurore juridike ngase prej këtij rasti ka mbetur i paafte për punë.

5.5. I dëmtuari M.D në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se qëndron pranë fjalës së dhënë në shqyrtimin e kaluar, dhe nuk ka diçka tjetër të shtojë. E në të cilën fjalë përfundimtare ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se paraqet kërkesë pasurore juridike ngase prej këtij rasti ka mbetur i paafte për punë.

5.6. E dëmtuara E.D në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar edhe më herët se personi I cili më ka rrahur me shkop I quajtur V.H asnjëherë nuk ka qenë I akuzuar për shkaktimin e lëndimeve ndaj meje, andaj kërkojë drejtësi që organet e ndjekjes të merren me këtë çështje.

5.7. Mbrojtësi i të akuzuarit F.D av. M.H, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin e kaluar. E në të cilin fjalë ka deklaruar, citat *“se i mbrojturi i tij në rastin konkret ka vepruar në kuadër të mbrojtës së nevojshme. Ngase i njëjti ka qenë i sulmuar nga anëtarët e familjes H, dhe rrjedhimisht ka qenë i detyruar që ta shpëtoj vetën e tij dhe familjarëve të tij dhe ta evitoj sulmin e atë qashtëm. Andaj, vepra e kryer në kuadër të mbrojtjes së nevojshme nuk konsiderohet vepër penale dhe i propozon gjykatës që për veprën penale Vrasje e Rëndë nga neni 147 par. 4 lidhur me par 1 ta liroj nga aktakuza, ndërsa për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të armës të parashikuar nga neni 328 par. 2 të KPK-së ti shqiptoj një sanksion sa më të butë ngaqë i njëjti veq se e ka pranuar fajësinë dhe është penduar thellë”*. Po ashtu mbrojtësi av.M.H në fjalën e tij përfundimtare ka shtuar se I mbrojturi I tij ka pranuar veprën penale për armbajtje pa leje nga neni 328/1 të KPK-së, ndërkaq nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale të Vrasjes së rëndë nga neni 147/4 lidh me par 1 të KPK-së. Më pas ka deklaruar citat *“para vetes keni një rast tipik shkollor se si ka ardhur deri te mbrojtja e nevojshme, dhe nëse ka ndonjë rast në praktike është rasti konkret, ku i mbrojturi im ka vepruar në suaza dhe rrethana të mbrojtjes së nevojshme”*. Andaj ka kërkuar nga trupi gjykoës që kundër të mbrojturit të tij të merr aktgjykim lirues ngase ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale.

5.8. I pandehuri F.D në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë tjetër.

5.9. Mbrojtësi I të pandehurit M.H – av.H.M në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se edhe pas administrimit të provave dhe vërejtjeve e sugjerimeve që janë dhënë nga gjykata e Apelit prokurorja nuk arriti që përtej limiteve ligjore të dyshimit të bazuar mirë të vërtetojë fakte të natyrës vendimtare të vërtetojë identitetin objektiv të ngjarjes dhe identitetin subjektiv të veprimeve që pretendon se I ka marr M H. Më tutje mbrojtësi ka shtuar citat, “përshkrimin faktik në akuzë nuk vërteton veprimet, njetin, mënyrën, e që janë elemente qenësore për figurën dhe cilësimin e veprës që M.H I ngarkohet, askund nuk është përshkruar veprimi individual I M.H se I njëjti rrezikojë jetën e pjesëmarrësve në këtë rrahje, në të kundërtën është administruar prova mbi natyrën e lëndimeve trupore që pësojë M.H dhe ato ishin të rënda dhe të rrezikshme për jetën e tij.

5.10. I pandehuri M.H në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë tjetër.

Mbrojtësja e të pandehurit I.H – av.M.B në fjalën e saj përfundimtare ndër të tjera ka theksuar se nuk ka dyshim se I mbrojturi I saj është involvuar në këtë ngjarje, mirëpo e tëra çfarë ka ndodhur, ka ndodhur pasi është ftuar nga dikush përmes telefonit duke kërkuar ndihmë dhe ajo çfarë ka ndodhur, ka ndodhur në përlëshje e sipër duke mos pasur mundësi ta kontrollojë veten dhe se I njëjti ka reaguuar si pasojë e detyrimit dhe nevojës për mbrojtje të nevojshme të jetës dhe të trupit të tij. Citat *“I mbrojturi im përherë është ankuar se në këtë përlëshje edhe vetë ka qenë I dëmtuar, dhe I ka edhe dëshmitaret e tjerë që mund ta dëshmojnë por kjo nuk është relevante në këtë fazë”*

5.11. I pandehuri I.H në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrahë fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë tjetër.

Mbrojtësi I të pandehurit A.H – av.M.N fjalën e tij përfundimtare e ka dorëzuar me shkrim, duke e elaboruar dhe ka shtuar se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin e kaluar gjyqësor, e në të cilën fjale përfundimtare në shqyrtimin e kaluar ka deklaruar, citat *“se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk manifestohen elementet e veprës penale për të cilën i njëjti akuzohet dhe për këtë arsyeje ta liroi nga aktakuza. Në variantin më të keq për të të njëjtin, ta shpall fajtor për veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 155 par. 1 KPP-së”*. Mbrojtësi av.M.N fjalën e tij përfundimtare e ka plotësuar duke theksuar se në bazë të dispozitivit të akuzës që ka të bëjë me të akuzuarin A.H, në dispozitivin e saj nuk përshkruhet asnjë veprim inkriminues për të mbrojturin e tij, e aq më pak duke pasur parasysh pretendimet e mbrojtjes dhe duke pasur për bazë edhe faktin që në këtë shqyrtim gjyqësor me propozimin e palës mbrojtëse është siguruar një ekspertizë mjeko – ligjore me të cilën vërtetohet se në ditën kritike I akuzuari A.H ka qenë I plagosur me armë zjarri dhe ka qenë në tretman të vazhdueshëm mjekësorë.

5.12. I pandehuri A.H në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrahë fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çfarë të shtojë tjetër.

## **6. Gjetjet e Gjykatës.**

6.1. Pas përfundimit të procedurës së provave, Gjykata këtë Aktgjykimin e saj e bazon vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtim gjyqësor. Gjykata me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një, edhe në lidhje me provat e tjera, duke nxjerrë përfundimin se faktet konkrete janë provuar dhe se në veprimet e të pandehurve formësohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat janë shpallur fajtor.

6.2. Gjykata arsyetimin e këtij Aktgjykimi do t'a filloj nga dispozita inkriminuese, pra vepra penale Vrasja nga neni 146 e cila përcakton; kushdo që privon personin tjetër nga jeta dënohet me së paku pesë vjet burgim, e që si verim i kryerjes së kësaj vepre konsiston në privimin e tjetrit nga jeta. Formë e kualifikuar kësaj vepre është Vrasja e Rëndë e parashikuar me nenin 147 par.4 që si element kualifikues ka kur i pandehuri privon nga jeta personin tjetër, dhe në atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave, pra vrasje e këtill konsiderohet kur kryesi për kryerjen e veprës përdorë aso mjetesh, ose vepron në aso rrethana që vënë në rrezik jetën e një ose më shumë personave, përveç atij ndaj të cilit është drejtuar veprimi i kryerjes, dhe për t'u konsideruar se vepra e tillë është kryer është e nevojshme të krijohet rrezikshmëri konkrete, pra krahas vrasjes së një personi të shkaktohet rrezik për personat e tjerë. Krahas këtij elementi objektiv, duhet të përmbushet edhe ai subjektiv pra dashja lidhur me veprën penale të vrasjes, si dhe me rrezikun e shaktimit të rrezikut konkret për jetën e ndonjë personi tjetër, por jo ta privoj nga jeta.

6.3. Gjykata do t'i bëjë një analizë edhe formës së kryerjes së veprës penale, apo bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale të paraparë në nenin 23 të KPK-së, si Bashkëkryerja, që përcakton: *“nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënim të paraparë për atë veprë”*. Lidhja objektive qëndron në atë që secili bashkëkryes duhet të marrë ndonjë veprim me të cilin i kontribuon kryerjes së veprës penale, pa marrë parasysh se këto veprime a merren në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, por duhet të jenë të lidhura midis tyre, dhe të jenë të drejtuara që të arrihet rezultati i njëjti. Lidhja subjektive qëndron në atë se të gjithë bashkëkryesit duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme.

6.4. **Nga deklarata e të dëmtuarit M.D**, u vërtetua fakti se në afërsi të fshatit Ribar i Madh ky dëshmitarë kishte vërejtur një kombi i cili ia kishte zënë rrugën autobusit dhe nga ai kombi kishin dalë pjesëtarët e familjes H, ku i pari ishte F.H me revole në dorë, dhe pas tij edhe anëtarët tjerë të familjes H ku A.H kishte një pajser në dorë, M.H kishte një sopatë në dorë, M H dhe V.H kishin hipur nga dera e pasme e autobusit dhe Xh i kishte vendosur tytën e revoles në barkë dhe përderisa i njëjti kishte tentuar t'ia hiqte revolen, të dëmtuarin M me teshlicë në dorë e kishte goditur i akuzuari I.H, ndërsa **Xh e kishte goditur me** revole dy here në këmbën e djathtë mbi gju dhe në afërsi të gjurit dhe më pas pjesëtarët tjerë të familjes H kishin filluar ta godasin me mjete si teshlicë I.H, ndërsa V.H me një stupcë në dorë dhe nga goditjet e mara posa kishte zbritur në tokë e kishte humbur vetëdijen.

6.5. **Nga deklarata e të dëmtuarit R.D** u vërtetua se ditën kritike derisa i njëjti ishte duke u kthyer me autobus së bashku me djalë dhe vëllait të tij F.D dhe vajzën e vëllait E.D, një kombi i

kishte dalë autobusit përpara dhe nga ai kombi kishin dalë pjesëtarët e familjes H. Gjithashtu edhe nga deklarimi i këtij të dëmtuari – dëshmitari u vërtetua se i pari në autobus kishte hipur F.H dhe kishte një revole në dorë i cili e kishte goditur me dy predha në këmbë dhe pas tij I.H me teshlicë në dorë i cili gjithashtu e ishte goditur, dhe i njëjti e kishte humbur vetëdijen.

**6.6. Nga deklarata e të dëmtuarës E.D** u vërtetua se përderisa ajo ishte duke u kthyer me vëllain e saj F. dhe xhaxhain R.D, kishte vërejtur se autobusi ishte ndalur në fshatin Ribar i Madh ngase ishte penguar nga një kombi nga i cili kishte parë të dilnin persona ku edhe kishte identifikuar F.H dhe I.H duke hyrë nga dera e parme e autobusit dhe ishin nisur në drejtim të vëllait të saj F.D në atë moment xhaxhai i saj R.D iu kishte dalë përpara dhe F.H e kishte goditur me revole ku edhe i njëjti e kishte humbur vetëdijen në atë moment kishte tentuar tani e dëmtuara të i del vëllait të saj F.D përpara por e kishte humbur edhe ajo vetëdijen.

**6.7. Nga deklarata e dëshmitarit F.D** u vërtetua se i njëjti derisa ishte duke e punuar arën e tij e kishte parë kombin e familjes H. duke lëvizur dhe se e kishte telefonuar djalin e tij F. dhe i kishte thënë të kenë kujdes dhe ta thërret policinë se familja H janë duke u sjellë dhe kur kishte mbërrite në vend ngjarje i kishte parë dy fëmijët te tij F dhe E.D të shtrirë në llogor.

**6.8. Nga dëshmia e dëshmitarit I H** u vërtetua se ditën kritike ai së bashku me vëllezërit e tij N, E dhe H.H ishte në autobus dhe se diku në fshatin Ribar derisa autobusi ishte duke lëvizur atë e kishin ndalur F dhe I.H e pas tyre ishin edhe A, M, M dhe B.H. Posa kishin filluar të shtënat e armëve ai kishte dalë nga autobusi dhe aty ishte kthyer kur e kishte thirrur vëllau i tij N. për ta marrë vëllaun E.H pasi ai ishte plagosur.

**6.9. Nga deklarata e V.H** u vërtetua se i njëjti kishte qenë i rrahur më herët para ngjarjes kritike nga ana e F, M, Sh dhe F.D ngase kishin pasur një ngatërresë të mëhershme.

**6.10. Nga deklarata e dëshmitarit H.H** u vërtetua se i njëjti ishte në autobus së bashku me vëllezërit e tij N.H, I.H dhe E.H kur autobusi ishte ndalur nga disa perona të cilët kishin një kombi me ngjyrë të kuqe ku ishin pjesëtarët e familjes H. Posa shoferi e kishte hapur derën e autobusit i pari kishte hipur F.H nga dera e parme dhe menjëherë kishte filluar rrahja dhe vëllai i tij E ishte plagosur në shpinë. I pari kishte filluar sulmin F.H duke e sulmuar R.D. Edhe pse dëshmitari ishte fshehur nën karrige ka dëgjuar të shtëna nga armët e zjarra katër- pesë të shtëna dhe të rrahura te dera e pasme e autobusit, duke theksuar se nuk ka mundur me pare asgjë. Kur është zgjuar ka parë vëllain e tij E. i cili ishte i gjakosur në shpinë i njëjti ishte i shtrirë në anën e majtë të autobusit me kokë në karrige, din se vëllai i tij E ka qenë i plagosur sipas tij nga shpina, predha i kishte mbetur në qafë, mirëpo pas operacionit është hequr, ku njëherit ka mbetur i paralizuar në pjesën e poshtme të trupit nga predhat. Se me familjen H dhe D para ditës kritike raportet i kanë pasur të mira, por tani e tutje nuk flasin më. Derisa ishte i fshehur nën karrigen ka pare së i akuzuari F.H ka ra në korridor të autobusit në afërsi të tij, por kush e ka plagosur nuk e din. Dëshmitari theksoj gjatë kohës që ishte i shtrirë (fshehur) nën karriga ka parë se F.H e ka sulmuar me grushta F.D derisa ishte ulur në karrige. Disa nga personat që kanë hypë në autobus sipas dëshmitarit kanë pasur ‘stupca’ por nuk ka qenë në gjendje ti identifikojë personat të cilët kanë pasur ‘stupca’, se nga kishte ardhur krisma e pare me armë zjarri nuk ka mundur ta dijë. Autobusin në ditën kritike sipas dëshmitarit ishte duke e

drejtuar F.J, dhe në momentin kur ishte ndalur autobusi dhe vendin ku është ndalur autobusi nuk ishte stacion lokal, kush e ka ndalur autobusin nga pjesëtarët e familjes H nuk e dinte, gjithashtu nuk din se kush e ka privuar nga jeta të ndjerin Q.H. Por thekson se nga furgoni i cili ishte ndalur në rrugë përveç personave që i ka përmendur nga aty ka zbritur edhe i ndjeri Q.H, ku më pas kishte hypë edhe në autobus në derën e pasme ku pas 600 m kishte ndodhur ngjarja në rrugën e Ribarit.

6.11. **Nga deklarata e N.H** u vërtetua se në fshatin Ribarë i Madh disa persona e kishin ndalur autobusin me të cilin po udhëtonte i cili autobus ishte penguar nga kombi dhe aty kishin hipur A dhe M H të cilët kishin filluar ti sulmonin anëtarët e familjes D të cilit ishin në autobus. Diten kritike me dt 05.09.2009 nga ora 07:00 deri në orën 19:00 kishte qenë në punë së bashku me vëllezerit e tij H, E e I H, në ndërtim të një shtëpie në Prugovc, pastaj kanë dalur për të pritë autobus, dëshmitari theksoj se ai është ulur në karrigen e dytë pas vozitësit, me të arritur në kthesë të fshatit Ribar ka vërejtur kombin e ndalur në anën e djathtë të rrugës në drejtim të lëvizjes së autobusit të parkuar në rrugë. Si kishte ardhur deri te ndalja e autobusit nuk e din, por më pastaj ishin hapur dyert e autobusit ku derën e pare kishin hyre dy – tre persona pastaj të tjerët. Duke theksuar se derën e pare fillimisht kanë hyrë A me Xh. Personat që kishin hypë në autobus kanë filluar ta sulmojnë F e R.D, sipas dëshmitareve të njëjtit persona kanë hipë në autobus me qëllim që ti sulmojnë Duriqët. Më pastaj momentin kur dëshmitari ishte jashtë autobusit ka dëgjuar dy lloj të shtëna armësh, ku të njëjtin më pas e kishin njoftuar se vëllai i tij E., ku dëshmitari ka hyrë prapë në autobus dhe kishte pare që vëllai i tij E ishte i shtrire më kokë në ulëse – dyfish, se i njëjti ishte i plagosur me gjak në shpinë.

6.12. **Nga deklarata e dëshmitarit A.J** u vërtetua se kur ishin hapur dyert e autobusit ishin futur pjesëtarët e familjes H dhe kishte filluar përleshja mes tyre dhe familjes D. Nga deklarata e dëshmitarit u vërtetua se i njëjti punon në kompaninë “T.T” më seli në fshatin Ribar i Vogël, KK Lipjan, në vendin e punës konduktor. Diten kritike janë nisur në ora 07:00 nga stacioni i autobusëve në Lipjan për në fshatin Kraishtë, ku ishin afërsisht 40 pasagjer ndoshta edhe më tepër, atë ditë nuk kishte vërejtur diçka të pa zakonit në autobus. Sa i kujtohet F.D ka qenë i ulur në ulësen e tretë apo të katërt pas vozitësit, ndërsa R.D ishte ulur në anën e kundërt në ulësen e tret, me të arritur në kthesën e fshatit Ribar të Madh, dëshmitari ishte i ulur në ulësen e fundit të autobusit me disa shokë duke biseduar, si ishte ndalur autobusi nuk din, por fillimisht ishte hapur dera e parë pastaj ajo e fundit, duke theksuar se sigurisht dikush ka hyrë në derën e parë, ndërsa derën e fundit ka parë udhëtar duke dalur. Momentin kur dikush ka hyrë nga dera e parë e autobusit ka dëgjuar zhurma dhe krisma. Dëshmitari në shqyrtim gjyqësor theksoj se përmes derës së pare kanë hyrë këta persona (pra këta persona që janë të ulur në bankën e të akuzuarit). Më pas dëshmitari nga frika ishte fshehur në karrige të pasme, nga aty kishte dëgjuar shtatë – tetë krisma nga arma e zjarrit, dhe krismat kishin ndodhur në pjesën e parë të autobusit në një interval kohor prej pesë deri dhjetë minuta. Derisa dëshmitari ishte brenda autobusit theksoj se nuk ka ndodhur asnjë plagosje, por kur ai kishte dalur nga autobusi kishin ikur të gjithë pasagjeret.

6.13. **Nga deklarata e dëshmitarit F.J** u vërtetua se i njëjti ditën kritike në fshatin Ribar i Madh kishte parë disa udhëtar dhe në autobus kishte hipur F.H dhe kishte filluar përleshja i

njëti e kishte marrë djalin e tij dhe kishte dalur nga autobusi menjëherë. Nga deklaratat e dëshmitarit F.J është vërtetuar se ditën kritike në autobus kishin diku 50 udhëtar, ku me vete kishte edhe djalin e tij A.J, dhe me të arritur në kthesën e fshatit Ribar kishte parë disa udhëtar që kanë ngritur dorën për t'ia ndaluar autobusin, se në atë moment përpara nuk ka parë kurfarë automjeti – kombi por vetëm udhëtarët. Në atë moment djali i tij A.J kishte filluar me qajtje, më pastaj me të hyrë F.H brenda menjëherë kishte filluar ngjarja, duke theksuar se familja D ishte ulur prapa tij. Posa djali i tij kishte filluar të qaj, dëshmitari theksoj se kishte dalur më të jashtë autobusit, ku nuk e din se si është zhvilluar ngjarja tragjike mes këtyre dy familjeve pra familjes H dhe D, ku ngjarja kishte ndodhur shpejt, por din se këto dy familje para një viti kishin pas një konflikt pra ishin të hasmuara, më pastaj pas ngjarjes ku dëshmitari thotë se ka zgjatur pesë- gjashtë minuta ja vërejtur një kombi të kuq ku kishin shkuar H. Dëshmitari gjithashtu theksojë se është e vërtetë ajo çka ka deklaruar në polici, duke theksuar se mund ti harron detajet sepse ka kaluar kohë e gjatë, por nga ri kujtimi i deklaratës nga ana e prokurores, i njëti është përgjigjur se po është e vërtetë që ka dëgjuar të shtëna me armë.

6.14. Gjykata përmes deklaratat së dëshmitarit V.H e vërtetoi se i njëti kishte qenë i rrahur më herët para ngjarjes kritike nga ana e F, M, Sh dhe F.D ngase kishin pasur një ngatërresë të mëhershme, fakt ky që vërteton motivin pse pjesëtarët e familjes H ku në mesin e të cilëve ishin edhe M, Ii, dhe A H, ditën kritike me datë 05.09.2009 në fshatin Ribar i Madh tani të pandehurit nga familja H kanë dalë nga kombi i tyre i tipit “Toyota” me targa ... me ngjyrë të kuqe , i cili ka qenë i ndaluar në mes të rrugës, e kanë ndaluar autobusin, pra të njëjtit i kishin dalë në pritë autobusit me të cilin po udhëtonin disa nga anëtarët e familjes D si F.D së bashku me axhën e tij R, vëllain M. dhe motrën e tij E.D të cilët kanë qenë duke udhëtuar me autobusin e firmës “T”, të cilin e drejtonte shoferi F.J, kjo rrethanë është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve – të dëmtuarve M.D, R.D, E.D, I H. Se janë ndaluar ditën kritike të pandehurit nga familja H, dhe kanë hyrë në autobusin me të cilin po udhëtonte familja D nuk e mohojnë as të pandehurit nga familja H, por se kanë version të ndryshëm për ngjarjen që ka ndodhur më pas.

Pasi që të pandehurit kishin ndaluar të autobusin të pandehurit F dhe Xh.H kanë qenë të armatosur me armë zjarri të tipit të pa njohur, ndërsa të pandehur dhe M. H me shkopinj druri, i pandehuri I me teslicë ndërsa I pandehuri A. me shufër hekuri, në atë mënyrë që i pari në autobus ka hyrë i pandehuri F.H me pistoletë në dorë dhe pasi që ju ka thënë D. “zbritni poshtë” dhe në atë moment ka shtënë me pistoletën e tij ka qëlluar në këmbë të dëmtuarin R.D duke i shkaktuar dëmtime të rënda trupore. Këto rrethana vërtetohen nga dëshmitë e dëshmitarëve M D, R.D, E.D, të cilët dëshmitarë janë konkret në përshkrimin e ngjarjes, e të njëjtat gjëra në një farë mënyre i vërtetojnë edhe dëshmitë e dëshmitarëve I H, H.H, si dhe dëshmitarët tjerë.

Këto dëshmi kanë besueshmëri edhe në prova materiale si Ekspertiza Mjeko – Ligjore e punuar nga eksperti mjekësisë ligjore T.G me datë 25.02.2010 në bazë të cilës është konstatuar se R.D ka pësuar një plagë tejshkuese me armë zjarri në anësinë e poshtme të djathë, në zonën e kofshës së djathtë, si dhe një plagë tejshkuese, nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arme zjarri, me besueshmëri në kanalën e saj ka përfshirë lëkurën dhe indet nënlëkurore,



muskujt e anësisë të poshtme në zonën kafshore që e ka përfshi edhe thyer edhe ashtin e kofshës së djathtë duke i shkaktuar plagë të hapur, lëndime këto të kualifikuara si lëndime të rënda trupore.

Pra të pandehurit M H, I.H, A H, duke qenë të pajisur me mjete te forta të përshkruara si më lartë, ku me ta ishin edhe të pandehurit F dhe M, kanë manifestuar shkallë të lartë të dashjes për të kryer veprën penale të vrasjes, e që ka qenë qëllimi i përbashkët i këtyre të pandehurve. Pra në veprimet e këtyre të pandehurve ekziston edhe lidhja objektive si bashkëkryerës në kryerjen e veprës penale, pra që të gjithë këta të pandehur kanë vepruar ditën kritike duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale, dhe duke kontribuar thelbësisht në kryerjen e saj, duke vepruar në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv, pra F dhe Xh.H kanë qenë të armatosur me armë zjarri të tipit të pa njohur, ndërsa të pandehurit B. dhe M.H me shkopinj druri, i pandehuri I me teslicë ndërsa I pandehuri A me shufër hekuri. Pra të pandehurit duke vepruar me dashje kanë qenë në dijeni dhe bashkërisht kanë marrë vendimin për të kryer vepër penale, secili duke kontribuar në kryerjen e veprës penale.

Përveç lidhjes objektive në veprimet e të pandehurve M, I, A ekziston edhe lidhja subjektive ngase të gjithë bashkëkryesit kanë qenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë, dhe do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme, pra të pandehurit F dhe Xh.H kanë qenë të armatosur me armë zjarri të tipit të pa njohur, ndërsa të pandehurit B. dhe M.H me shkopinj druri, i pandehuri I me teslicë ndërsa I pandehuri A me shufër hekuri, ku këta të fundit duke i goditur tani të dëmtuarit, kanë parandaluar mbrojtjen e tyre eventuale, me këtë rast i kanë mundësuar të pandehurve të armatosur që të kryejnë veprimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Se të pandehurit I, M A, dhe Bedri, me pajisë si më lartë ju ka shkaktuar dëmtime të rënda trupore të dëmtuarve R, M është vërtetuar nga ekspertizat mjekësore per R.D e dt.25.02.2010, për M.D kjo rrethanë vërtetohet në bazë të ekspertizës së datës 25.02.2010, dhe për E.D është vërtetuar se e njëja ka pësuar dëmtime të lehta trupore bazuar në ekspertizën mjeko – ligjore të datës 21.04.2017, ekspertizë kjo e bërë në bazë të dokumentacionit të çështjes.

6.15. Për Gjykatën nuk është kontestuese se i pandehuri F.D ditën kritike ka qenë duke udhëtuar me autobusin e firmës “T”, të cilin e drejtonte shoferi F.J, dhe i cili autobus më pastaj ishte ndaluar nga anëtarët e familjes H, pra të pandehurit e akuzuar, kjo është vërtetuar nga të gjitha dëshmitë të dhëna në Gjykatë, por një rrethanë e tillë nuk kontestohet as nga vet i pandehuri F.D.

Gjykata e ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri F.H i pari kishte hyrë në autobus ka hyrë i pandehuri F.H me pistoletë në dorë dhe pasi që ju ka thënë D. “zbritni poshtë” dhe në atë moment ka shtënë me pistoletën e tij ka qëlluar në këmbë të dëmtuarin R.D duke i shkaktuar dëmtime të rënda trupore.

Bazuar në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, ku i pandehuri F.D duke qenë paraprakisht I përgatitur, për të zbrapsur sulmin të atëçastshëm dhe real prej vetës dhe të tjerëve, ka nxjerrë nga brezi pistoletën e tipit Crevena Zastava M-57 e kal .7.62 x 25mm me nr.serik G-82691 të cilën e mbante pa autorizim dhe ka

shtënë fillimisht në drejtim të këmbëve të pandehurit F.H, dhe pasi i pandehuri F ka pushuar se sulmuari – gjuajtur me armë, i pandehuri F.D duke vepruar në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme ka shtënë një herë edhe në drejtim të Q.H I cili ka qenë në autobus, nga i cili plumb Q.H ka ndërruar jetë në Qendrën Emergjente në Prishtinë.

Pra është vërtetuar fakti se ka ekzistuar sulmi i atëçastshëm dhe real për jetën dhe trupin e të pandehurit F.D, gjithashtu Gjykata e ka vërtetuar faktin se pasi që i pandehuri F.D kishte filluar zmbropsjen e sulmit ndaj vetës dhe personit tjetër, ka shtënë në drejtim të pandehurit F dhe e godet në dy këmbët të akuzuarin F.H, mirëpo edhe pse sheh se i akuzuari F rrezohet nga të shtënat e tij, sulmin e të cilit deri një masë e zmbropsë, dhe në atë moment tejkalon suazat e mbrojtjes së nevojshëm, duke shtënë një herë edhe në drejtim të Q.H I cili ka qenë në autobus, nga i cili plumb Q.H ka ndërruar jetë në Qendrën Emergjente në Prishtinë, me ç'rast i pandehuri F.D ka rrezikuar kështu edhe jetën e njerëzve tjerë në autobus, ku nga një e shtëne e pa kontrolluar e të pandehurit F, është qëlluar edhe udhëtari i rastit në autobus E H, i cili ka pësuar dëmtime të rënda trupore të rrezikshme për jetën e tij, ndërsa nga të shtënat e të pandehurit F lëndime trupore kanë marrë edhe të pandehurit H.

6.16. Gjykata, ia fali besimin deklaratës së të akuzuarit F.H në pjesën ku thotë se i akuzuari F.D e kishte goditur me dy predha në këmbë, por nuk ia fali besimin deklaratës së të akuzuarit F.H në pjesët tjera ngase i njëjti ka deklaruar se kishte pranuar një sms nga tani i ndjeri Q duke i thënë se është në autobus dhe po kërcënohet nga familja D. Ngase nga raporti i telefonisë mobile Vala respektivisht PTK –së në lidhje me bisedat telefonike dhe sms-të nuk figuron askund se i akuzuari F të ketë komunikuar më tani të ndjerin Q. Gjithashtu edhe dëshmitarët ishin të ndarë në dy grupe ku njeri grup pretendon se Qi kishte hipur në autobus më herët dhe grupi tjetër që pretendon se Qi kishte hipur në autobus së bashku me të akuzuarit tjerë të familjes H. Gjithashtu, deklarata e këtij të akuzuarit nuk përputhet as me deklaratën e të dëmtuarit R i cili deklaroi se posa i akuzuari F kishte hipur në autobus kishte nxjerrë revolen edhe e kishte shkrepur në drejtim të tij me çka, edhe e kishte goditur me plumb në fund të barkut, dhe kjo është vërtetohet me konstatimet dhe mendimet mjeko ligjore për të dëmtuarin R.D, të dhëna me datë 22.02.2010 nga eksperti Dr. T.G. Deklarimi i të akuzuarit F është në shpërputhje të plotë edhe me deklaratat e dëshmitarëve okular të cilët nuk kishin asnjë nevojë që të shtonin apo të ndryshonin ndonjë rrethanë si p.sh dëshmitari I H, H.H dhe N.H të cilët deklaruan se jo vetëm F.H por edhe tërë pjesëtarët tjerë të familjes H kishin hipur në të njëjtën kohë në autobus.

Mirëpo gjykata nuk ia fali besimin në pjesët e tjera të deklaratave të tyre ngase të njëjtit në mënyrë që ti ikin përgjegjësisë penale tentojnë ti shtrembërojnë faktet e kjo më së miri vërtetohet nga deklaratat e tyre të cilat janë në kundërtënie të mëdha me deklaratat e dëshmitarëve okular dhe të dëmtuarve. Të akuzuarit H kanë deklaruar se nuk kanë pasur asgjë në dore dhe se në autobus ka hyrë së pari vetëm i akuzuari F.H e më pastaj kur kanë dëgjuar krismat janë nisur në drejtim të autobusit është në kundërshtim të plotë edhe me deklaratat e dëshmitarëve të I, H dhe N.H, cilët përmendin se kanë parë të gjithë të akuzuarit duke hyrë në autobus në të njëjtën kohë disa me armë në dorë e të tjerët me mjete tjera për tu përleshur p.sh. dëshmitari I.H i cili nuk ishte pjesë e problemit por dëshmitar okular dhe se i rastisi të gjendej

në autobus, deklaroi se autobusin e kanë ndalur F dhe I.H e pas tyre ishin edhe A, M, M dhe B.H. Gjithashtu edhe dëshmitari tjetër H.H deklaroi se kishte parë 4-5 persona të familjes H që nuk ishte në gjendje me identifikur ta kene ndalur autobusin ndërsa i kishte identifikuar të tjerët si M, I dhe V.H. Pra gjykata ia fali besimin këtyre dëshmitarëve ngase të njëjtit nuk kishin ndonjë arsye për të gënjyer bile për më tepër edhe vëllai i tyre E H u vërtetua se është plagosur dhe ka mbetur i palëvizshëm nga i akuzuari F.D. Ndërsa të akuzuarit për të ikur nga përgjegjësia penale nuk e thanë të vërtetën.

Gjithashtu edhe deklaratat e të dëmtuarve janë në përputhje të plotë njëra me tjetrën p.sh., deklaratimet e të dëmtuarve E, R dhe M.D janë në përputhje të plotë me njëra tjetrën e të cilat deklarata kanë mbështetje edhe në ekspertizat mjeko ligjore për të dëmtuarit R.D, M.D dhe E H të dhëna me datë 25.02.2010, nga eksperti Dr. T.G, e nga të cilat ekspertiza vërtetohet se të dëmtuarit R.D i janë shkaktuar plagë tejkuese nga arma e zjarrit e që bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore me elemente të rrezikshme për jete. Gjithashtu edhe sa i përket të dëmtuarit M D i janë shkaktuar plagë tejkuese nga arma e zjarrit e që bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore të zakonshme si dhe për të dëmtuarin E.H se ka dy plagë tejkuese dhe konsiderohen si dëmtime të rënda trupore të rrezikshme për jete që janë shoqëruar edhe me dëmtimin e pjesëve të trupit me rëndësi jetësore.

Nga provat material respektivisht nga raporti i autopsisë u vërtetua se i ndjeri Q.H është shkaktuar plagë nga arma e zjarrit në abdomen, fshikëzën urinare dhe rupturat (çarjet) e arterjes dhe venës inguinale në anën e djathtë të cilat kanë shkaktuar disa hemoragji (gjakderdhje) dhe janë shkaktuar nga arma e zjarrit nga një gjuajtje me plumb dhe si pasojë ka ardhur deri te anemia akute dhe vdekja e tani të ndjerit Q.

Nga raporti i ekzaminimit kriminalistik –sektori i armëve të zjarrit dhe gjurmëve të veglave i datës 01.12.2009 është vërtetuar se tetë (8) gëzhoja, pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62 x 25 mm janë gjuajtur prej dy (2) armëve të të njëjtit kalibër 7.654x25 mm dhe atë 5 gëzhoja janë gjuajtur nga njëra armë dhe 3 nga arma tjetër. Pesë (5) nga këto gëzhoja janë gjuajtur nga pistoletat Cërvena Zastava M- 57 e kalibrit 7.65x25mm me nr serik G-82691, e nga e cila edhe është qëlluar i ndjeri Q.H dhe janë plagosur E.H, F.H dhe B.H.

## **7. Vendimi mbi dënimin**

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysht rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, të parapara me nenin 64 të KPPK ku me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pati parasysht të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe ato lehtësuese.

Për të pandehurin F.D gjykata si rrethana lehtësuese mori faktin se nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar për vepra penale, rrethanat e tij familjare, ndërsa si rrethanë reënduese gjykata

mori dënmrimin e vlerës së mbrojtur e që është jeta e njerit, ku si pasojë e veprimeve të tij, ka ndërruar jetë tani i ndjeri Q.H.

Sa i përket të akuzuarit M.H si rrethanë lehtësuese gjykata mori rrethanat familjare se i njëjti është person familjar, i moshës relativisht të re dhe më parë i pagjykuar, ndërsa si rrethanë rënduese, pasojat e shkaktuara si dhe qëllimin e të akuzuarit që ti hakmerret F.D për një rrahje që kishte ndodhur më herët.

Gjithashtu edhe sa i përket të akuzuarit I.H si rrethanë lehtësuese gjykata mori rrethanat familjare se i njëjti është person familjar, me parë i pa gjykuar, ndërsa si rrethanë rënduese rrezikshmërinë e veprës penale, pasojat e shkaktuara si dhe qëllimin e të akuzuarit që ti hakmerret F.D për një rrahje që kishte ndodhur më herët.

Gjithashtu edhe sa i përket të akuzuarit A.H si rrethanë lehtësuese gjykata mori rrethanat familjare se i njëjti është person familjar i moshës relativisht të re, më parë i pagjykuar ndërsa si rrethanë rënduese rrezikshmërinë e veprës penale, pasojat e shkaktuara si dhe qëllimin e të akuzuarit që ti hakmerret F.D për një rrahje që kishte ndodhur më herët.

Gjykata është e bindur se me dënimin si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale, dhe ky dënim të ndikoj te të pandehurit që të përmbahet nga përsëritja e veprave penale, po ashtu të arrihet edhe qëllimi ndëshkimorë në kuptim të preventives gjenerale, që dënimi i shqiptuar të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarve për dëmet e shkaktuara nga vepra penale, por edhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi konfiskimin e e sendit u morr konform nenit 60 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr në bazë të nenit 450 të KPPK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

### **DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**

**PKR. 405/15 datë 08.02.2018**

**Sekretare Juridike**

**Shqipe Rexhepi**

**Gjyqtari:**

**Arben H**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykim është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.